



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimar / Dorezuar Prilijena / Prodato Received / Delivery	29.11.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinita Org. / Unit	Hi / Prot Hi / Prot Prot. No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK	7094/2023		117



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1269/2023

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Percuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1269/2023, të datës 11.10.2023, të parashtruar nga ankuesja të cilën me autorizim e përfaqëson Izet Shala, avokat nga Prishtina kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.11.2023, mori këtë:

#### V E N D I M

- I. **Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.1269/2023, e datës 11.10.2023, e parashtruar nga ankuesja
- II. **Mbetet në fuqi** Vendimi Nr.146/2023, i datës 19.09.2023, i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

#### A r s y e t i m

Ankuesja (me tej referuar ankuesja), më datë 11.10.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e regjistruar nën shenjë A.nr.1269/2023, kundër Vendimit me Nr.146/2023, të datës 19.09.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, lidhur me refuzim e aplikacionit në Konkursin me numër të referencës RN00012073, për pozitën e grupit “Specialist të Administrimit të Përgjithshëm”, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, LPPA dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej vetëm Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 16.10.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ndërsa, ky i fundit, me datë 18.10.2023, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me provat materiale lidhur me këtë çështje.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.Prot:6483/2023 të datës 11.10.2023, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.146/2023 të datës 19.09.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Vendimin Nr.415/2023 të datës 08.09.2023 të Departamentit për Zhvillimin e Zyrtareve Publikë; Ankesën e ankueses të datës 11.09.2023 e parashtruar tek Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë; CV-në e ankueses së bashku me dokumentacionin përkatës të bashkangjitur dhe atë: Kopjen e letërnjoftimit, Vërtetimin me Nr.789 të datës 14.09.2023 Drejtoria për Mirëqenie Sociale-Qendra për Punës Sociale, Vërtetimin e datës 29.09.2023 nga Kompania Rajonale e Ujësjiellit "Bifurkacioni Sha" në Ferizaj, Certifikatën shëndetësore të datës 13.09.2023 nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Prishtinë, Vërtetimin me Nr.Prot.3099 të datës 29.09.2023 nga Ministria e Ekonomisë-Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, Deklaratën e datës 11.09.2023 të ankueses lidhur me masën disiplinore, Autorizimin e datës 11.09.2023 nga përfaqësuesi me autorizim i ankueses; Konkursin me numër të referencës RN00012073 të datës 14.07.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 16.10.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 19.10.2023 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë-MPB së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës si: Listën e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar e gjeneruar tek SIMBNJ; Njoftimin e datës 11.09.2023 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë lidhur me listën e ngushtë të kandidatëve konkurrues; Njoftimin e datës 19.09.2023 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë lidhur me plotësimin e listës së ngushtë të kandidatëve konkurrues; Aplikacionin e ankueses të datës 05.08.2023 së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur me rastin e aplikimit dhe atë: Diplomën me Nr.58/22 të datës 08.12.2022 nga Kolegji Iliria në Prishtinë; Vërtetimin me numër Lrp.nr.7462/2022 të datës 15.12.2022 nga noterë V.I.A në Prishtinë; Shkresën zyrtare me numër 5062 të datës 16.12.2022 nga Kolegji Iliria; Diplomën me Nr.90/07 të datës 31.12.2007 nga Universiteti Mbretëror Iliria në Prishtinë; Vërtetimin me numër Lrp.nr.6646/2022 të datës 02.11.2022 nga notere V.I.A në Prishtinë; Licencën e punës me numër KO-12548-05-4 të datës 02.11.2020 të lëshuar nga Oda e Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor në Kosovës; Certifikatën nga The Kosovo Chamber of nurses midwives and other health professionals për periudhën 06-07 maj 2021; Certifikatën nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për periudhën 26 maj deri më 20 qershor 2020; Certifikatën e datës 11.12.2020 nga Premium Quality-Best Choice; Certifikatën e datës 01.11.2019 nga Premium Quality-Best Choice; Certifikatën nga Smart Events të datës 13.03.2015; Certifikatën nga Shërbimi Doganor i UNMIK-ut për periudhën 29 qershor-28 korrik 2006; Certifikatën nga Besa Security të datës 05.10.2021; Vendimin me Nr.Prot.1910 të datës 15.08.2022 të Ministrisë së Ekonomisë; Vendimin me Nr.06/92 të datës 10.08.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr.19/2015, të datës 01.04.2015, të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Kontratën e punës( data te pa lexueshme) Vërtetimin me numër 153752/20223 të datës 29.09.2006 nga Posta dhe Telekomit i Kosovës; Vërtetimin e datës 22.03.2022 nga Migros Group Shpk; Vërtetimin e datës 20.09.2008 nga Qendra

për Zhvillimin e Biznesit; Letër rekomandimin e datës 07.08.2006 nga D.GJ-UNMIK; Vendimin me Nr.79/13 të datës 16.07.2013 të Ministrisë së Shëndetësisë; Certifikatën nga Qendra për Aftësimin Profesional “Loni Com”; Letër referencën nga Besa Security; Letër referencën e datës 24.05.2022 nga Meridian Corporation; Letër rekomandimin e datës 16.11.2009 nga Meridian Corporation; Pasqyrën e llogarisë së trustit për periudhën nga data 24.03.2009-01.08.2023; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 23.06.2023 nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës si dhe Letër motivimin e ankueses për Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankueses është e pabazuar, *sepse*:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Njësia Përgjegjëse-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, me datë 14.07.2023, ka publikuar Konkursin për praninë, me numër reference RN00012073, për emrin e grupit “Specialist i Administrimit të Përgjithshëm”, me titull të vendit të punës “Inspektor i Tregut” në Inspektoratin e Tregut Prishtinë/Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, klasa “Profesional 1”, 27 pozita. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 04.08.2023 deri me datë 11.08.2023, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja me datë 05.08.2023.

Në fazën e shqyrtimit paraprak, Njësia përgjegjëse me Vendimin Nr.415/2023, të datës 08.09.2023 ka refuzuar aplikacionin e ankueses. Rrjedhimisht, ankuesi nuk është përfshirë në listën e ngushtë për të vazhduar në fazën tjetër të procedurës për pozitën përkatëse të punës, me arsyetimin se i njëjta me rastin e aplikimit nuk ka bashkangjitur dëshmitë: nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e kërkuar të punës, është në sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati me të cilin dëshmohet së pala nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik. Nëse përvoja e punës e deklaruar është në sektorin privat brenda ose jashtë vendit, në një OJQ brenda apo jashtë vendit apo angazhimi nga i cili rrjedhë përvoja e punës është në ndonjë formë e marrëdhënies kontraktuale që nuk nënkupton marrëdhënie pune, atëherë është i nevojshëm një vet deklaram i nënshkruar se ai/ajo, nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Ankuesja e pakënaqur me refuzimin e aplikacionit, me datë 11.09.2023, ka parashtruar ankesë pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ndërsa, ky i fundit me Vendimin Nr.146/2023, të datës 19.09.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses, me arsyetimin se të njëjtës i mungon dëshmia lidhur me masën disiplinore, ashtu siç është kërkuar në konkurs.

Në funksion të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore referuar procedurës dhe kushteve të pranimit të nëpunësve civilë, përkatësisht:

- Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, (i aplikueshëm në këtë periudhë), ku me nenin 34 është përcaktuar se: 1. *Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, pranimi në Shërbimin Civil bëhet në kategorinë profesionale në grupin e administrimit të përgjithshëm dhe në secilin nga grupet e administrimit të veçantë.* 2. *Pranimi në kategorinë profesionale bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur dhe publik. Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike dhe sipas nevojave dhe së paku një herë në vit, për grupin e administrimit të përgjithshëm dhe për secilin nga grupet e administrimit të veçantë.* 3. *Konkurrimi organizohet nga DMZP për institucionet e administratës*

shitetërore dhe nga Njësia e Burimeve Njerëzore për çdo institucion tjetër (në tekstin në vijim: njësia përgjegjëse). 4. Njoftimi për hapjen e procedurës të konkurrimit shpallet në një afat jo më të shkurtër se 21 ditë, nga data e përcaktuar për paraqitjen e aplikimit, nga njësia përgjegjëse, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me mjete të tjera të përshtatshme. Afati për pranimin e aplikacioneve nuk mund të jetë më i shkurtër se 8 dite dhe jo më i gjatë se 15 ditë kalendarike. 5. Shpallja e konkursit, sipas paragrafit 4 të këtij neni, përfshin përshkrimin e përgjithshëm të punës për grupin përkatës, pozitat e punës të lira në grupin përkatës, kriteret që duhet t'i plotësojnë kandidatët, afatin për aplikim, të dhënat e hollësishme për zhvillimin e procesit të përzgjedhjes dhe dokumentacionin që duhet paraqitur për aplikim. 6. Konkurrimi zhvillohet në dy faza: 6.1. verifikimi paraprak, nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; 6.2. vlerësimi i njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 7. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia e përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Komisioni i pranimit (në vijim: Komisioni i pranimit), i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë për të cilin zhvillohet konkurrimi....

-Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku neni 10 parasheh se : 1.Shpallja e konkurrimit për një Grup të caktuar përmban, , këto të dhëna: 1.1. përshkrimin e përgjithshëm të punës së Grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 1.2. Kërkesat e përgjithshme për pranim sipas nenit 8 të LZP; 1.3. kërkesat e përgjithshme formale; 1.4. njohuritë, aftësitë dhe cilësitë që vlerësohen në procedurën e konkurrimit (kërkesat e përgjithshme të nevojshme); 1.5. listën e pozitave, aktualisht të lira, të Grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 1.6. mënyrën për paraqitjen e aplikacioneve; 1.7. afatin përfundimtar për pranimin e aplikacioneve të përcaktuar me datë të së kalendarike; 1.8. dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikacionit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre; 1.9. mënyrën e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve; 1.10. mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët...” 2.Të gjitha shpalljet e konkurrimit, gjithashtu, përmbajnë këto shënime: 2.1. “Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj”; 2.2. “Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen”; 3. Kushtet për aplikim, në pajtim me paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të këtij neni, përfshijnë kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë në pajtim me nenin 8 të Ligjit dhe kërkesat e veçanta të pranimit në Grupin për të cilin zhvillohet konkurimi, të përcaktuara sipas dispozitave të Rregullores për klasifikimin e punëve në shërbimin civil. 4. Të gjitha dokumentet e dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e konkurimit, kandidati, përmes aplikacionit, vet deklaroi se janë të vërteta dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e tyre. Deklarimi i rrejshëm paraqet shkak për përjashtimin nga procedura e pranimit. Neni 12 përcakton se: Përmbajtja e aplikacioneve 1. Aplikacioni përmban këto të dhëna: 1.1. një referencë në shpalljen e konkurimit; 1.2. të dhënat personale të kandidatit; 1.3. nivelin e arsimit si dhe diplomat e fituara, institucionet arsimore, datat e diplomimit; 1.4. një përshkrim të hollësishëm të përvojës së punës, duke përfshirë: emrin e punëdhënësit, funksionet, titujt, rangjet, kohëzgjatja e punës, një përshkrim i shkurtër i detyrave, numri dhe lloji i personelit nën mbikëqyrje, adresa e punëdhënësit, arsyet për largimin nga vendi i punës; 1.5. njohuritë gjuhësore; 1.6. informata mbi trajnimet e veçanta të kryera, kualifikimet profesionale dhe specializimet, aftësitë e veçanta dhe publikimet; 1.7. njohuritë kompjuterike; 1.8. emri, adresa dhe numri i kontit të dy (2) personave referues; 2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurimit, kandidatët duhet të bashkëngjitin edhe dokumentacionin si në vijim: 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit, dhe 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të

përcaktuara në shpalljen e konkurimit dhe të deklaruara në aplikacion. Neni 14 përcakton se: Neni 14 Fazat e konkurrimit 1. Konkurimi për pranimin në shërbimin civil, përfshin dy faza: 1.1. Verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. Vlerësimi i kandidatëve. Neni 15 përcakton se: 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërliken me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë. 4. Kandidatët të cilët plotësojnë kushtet për aplikim renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Lista shpallet në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 5. Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katërmbëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 6. Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj.

Në kuptim të dispozitave ligjore si më lartë, Kolegji i Këshillit ka analizuar konkursin me numër Reference RN00012073 për emrin e grupit Specialistë të Administrimit të Përgjithshëm, titulli i vendit të punës "Inspektor i Tregut", ku si kërkesa të përgjithshme formale për këtë pozitë të punës janë përcaktuar: - **Arsimi:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve në fushat :Arsim i lartë i paspecifikuar- **Përvoja e punës:** Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës.

Ndërsa, sipas Klauzolës nr.7 të konkursit, si dokumente për aplikim janë specifikuar: - **Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimin apo in që dëshmon se diploma e marrë jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit;**- **Kopje e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjitet se paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale;** - **Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;** - **Dëshmi përkatëse se kandidati/ja ka zotësi të plotë për të vepruar;** - **Dëshmi mjekësore se kandidati/ja është në gjendje të mirë shëndetësore për, dëshmia duhet të jetë jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj;** - **Certifikatë/vërtetim nga Gjykata ose nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilën dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prere për kryerjen e një veprë penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit.** - **Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojë e kërkuar e punës, është në sektorin publik atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati/ja me të cilën dëshmohet se ai/ajo nuk ka ndonjë masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik;** - **Nëse përvoja e punës e deklaruar është në sektorin privat brenda ose jashtë vendit, në një OJQ brenda apo jashtë vendit apo angazhimi nga i cili rrjedhë përvoja e punës është në ndonjë formë e marrëdhënies kontraktuale që nuk nënkupton marrëdhënie pune, atëherë është i nevojshëm një vet deklaram i nënshkruar se ai/ajo, nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.**

Mbi bazën e plotësimit të kërkesave të përcaktuara me konkurs, Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesja me rastin e aplikimit, nuk ka ofruar dëshmi se e njëjta nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, rrjedhimisht, sipas dëshmive materiale rezulton se ankuesja ka përvojë pune në sektorin publik, gjegjësisht e njëjta sipas Vendimit me Nr.Prot.1910 të datës 15.08.2022 të Ministres së Ministrisë së Ekonomisë, është emëruar anëtare e Komisionit të Auditimit në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Ujësjetësit “Bifurkacioni” SH.A Ferizaj, ndërsa, me Vendimin Nr.06/92 të datës 10.08.2022, të Qeverisë së Republikës së Kosovës është emëruar drejtor në Bordin e Kompanisë Rajonale të Ujësjetësit Bifurkacioni”, SHA Ferizaj, kurse, sipas shkresave të lëndës nuk vërtetohet fakti se ankuesja ka dorëzuar dëshmi siç është përcaktuar me klauzolën nr.7 të konkursit ku thuhet: *“Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojë e kërkuar e punës, është në sektorit publik atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati/ja me të cilën dëshmohet se ai/ajo nuk ka ndonjë masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik”*. Ndërlidhur me këtë, Kolegji nga provat e parashtruara nga ankuesja ka gjetur se e njëjta me rastin e parashtrimin të ankesës në Këshill ka bashkangjitur Vërtetimin e datës 29.09.2023, të lëshuar nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve në Kompaninë Rajonale të Ujësjetësit “Bifurkacioni” Sh.A në Ferizaj, sipas të cilit dëshmohet se ndaj ankueses në pozitën e Anëtares së Bordit të Drejtorëve pranë kësaj kompanie, nuk është shqiptuar masë disiplinore dhe nuk zhvillohet procedurë për shqiptimin e ndonjë mase disiplinore në fuqi, e të cilin dokument ankuesja nuk e kishte dorëzuar me rastin e aplikimit në konkursin me numër të referencës RN00012073. Rrjedhimisht, ky dokument mbanë datën e lëshimit 29.09.2023, duke nënkuptuar se i njëjti është lëshuar jashtë afatit të aplikimit sipas konkursit, e që ka qenë nga data 04.08.2023 deri më 11.08.2023. Po ashtu, ankuesja me rastin e parashtrimin të ankesës në Këshill, ka bashkangjitur edhe vet deklaratën e datës 11.09.2023, sipas të cilës ka dëshmuar se përgjatë marrëdhënies se punës si Anëtare e Bordit dhe Anëtare e Auditimit të Drejtorëve në Kompaninë Rajonale të Ujësjetësit “Bifurkacioni” ShA në Feriza, nuk ka pasur të shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Kolegji i Këshillit nga dokumentacioni i dorëzuar nga ankuesja me rastin e aplikimit ka gjetur se e njëjta ka përvojë pune edhe në sektorin privat, mirëpo, që me rastin e aplikimit nuk ka dorëzuar vet deklaratë ashtu siç kërkohej me konkurs ku përcaktohet se: *Nëse përvoja e punës e deklaruar është në sektorin privat brenda ose jashtë vendit, në një OJQ brenda apo jashtë vendit apo angazhimi nga i cili rrjedhë përvoja e punës është në ndonjë formë e marrëdhënies kontraktuale që nuk nënkupton marrëdhënie pune, atëherë është i nevojshëm një vet deklaram i nënshkruar se ai/ajo, nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.*

Andaj, bazuar në gjendjen e fakteve si më lartë, dhe duke qenë se ankuesja nuk ka arritur të argumentoj me asnjë provë se e njëjta me rastin e aplikimit, rrjedhimisht, gjatë afatit të hapur për aplikim (04.08 deri 11.08.2023) të ketë dorëzuar dëshmitë përkatëse mbi gjendjen e masave disiplinore në fuqi, Kolegji vlerëson se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankueses, dhe si rrjedhojë njësia përgjegjëse, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me rastin e nxjerrjes së vendimit të goditur me ankesë ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe në këtë mënyrë ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përkatësisht nenin 10 paragrafin 2, nën paragrafin 2.2 ku përcaktohet se: *“Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen”*; nenin 12 paragrafin 2 nën paragrafin 2.3 ku theksohet se: *Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurrimit, kandidatët duhet të*

*bashkëngjitin edhe dokumentacionin si në vijim: 2 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruar në aplikacion...”, si dhe nenin 15 paragrafin 5 ku përcaktohet se: 5.”Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin”.*


Theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

*Lënda me numër A.nr.1269/2023*

Ardita Perçuku-Shyti

  
Procesmbajtëse



### Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit me autorizim të ankueses avokatit
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/MPB dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.